



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 162/1 Prot.

Tiranë, më 09/02/2023

VENDIM

Nr. 7 DATË 09/02/2023

MBI

**“PROPOZIMET PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE UDHËHEQËSIT SHKENCORË
PËR CIKLIN E TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË NË MUZIKOLOGJI” NË
FAKULTETIN E MUZIKËS PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, për “*Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”, në “*Rregulloren e funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve*”, pasi shqyrtoi shkresën nr. 98/1 prot., datë 07.02.2023 të FM dhe nr. 162 prot. datë 08.02.2023 të UART, nëpërmjet të cilës përcillen propozimet për kuotat e pranimit dhe udhëheqësit shkencorë për ciklin e tretë të studimit “Doktoratë në Muzikologji” dhe pas diskutimeve,

V E N D O S I:

1. Pranimin e propozimit për kuotat e pranimit dhe udhëheqësit shkencorë për ciklin e tretë “Doktoratë në Muzikologji” në Fakultetin e Muzikës të UART sipas tabelës bashkëlidhur shkresave përcjellëse nga fakulteti.
2. Ky vendim t’i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



Handwritten text, possibly a signature or name, oriented vertically.

Handwritten text, possibly a signature or name, oriented vertically.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANATI

Nr. 16,2 Prot
08/02/2023

Nr. Prot. 98/1

Tiranë, më 07.02.2023

Lënda: Mbi kuotat dhe udhëheqësit shkencorë për ciklin III, doktoratë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024

Kryetarit të Senatit Akademik

Universiteti i Arteve

Sheshi Nënë Tereza

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur do të gjeni propozimin e Njesisë Bazë KMDP, mbi kuotat dhe udhëheqësit për ciklin III, doktoraturë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024.

DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu

FAKULTETI MUZIKËS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
NJËSIA BAZË KMDP

Nr. 98 prot.

Tiranë, më 07.02.2023

Lënda: Mbi kuotat dhe udhëheqësit shkencorë për ciklin III, doktoratë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024

**Dekanit të Fakultetit të Muzikës
Universiteti i Arteve
Sheshi Nënë Tereza**

I nderuar Z. Dekan

Pranë Njesisë Bazë KMDP, e më tej në Fakultetin e Muzikës, sikurse jeni në dijeni, ka përfunduar procesi i konkurrimit dhe regjistrimit të kandidatëve të Ciklit III, për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në Muzikologji. Përgjatë këtij procesi është vërejtur një interes i madh i kandidatëve për tu regjistruar çka ka rezultuar, përfundimisht, me regjistrimin në konkurs të 20 (njëzet) aplikantëve. Gjithsesi, panvarësisht cilësisë së aplikantëve, të kushtëzuar nga kuotat e aprovuara janë mundur të shpallen, për vitin akademik 2023-2024, 12 (dymbëdhjetë) fitues, ndërkohë që mbeten ende vetëm 3 (tre) kuota për tu plotësuar.

Lidhur me sa më sipër dhe bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 *Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, Neni 25, Pika 3, Neni 79, Pika. 4, VKM Nr. 112, datë 23. 02. 2018 *Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të Standarteve Shtetërore për fitimin e Titujve Akademikë “Professor i Asociuar” dhe “Professor”* i ndryshuar, Urdhrin e Ministrisë së Arsimit Nr. 128, datë 16.03.2022 *Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Muzikologji”, në Universitetin e Arteve Tiranë, Rregulloren e Programit të Studimeve të*

Ciklit III për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Universitetin e Arteve, Neni 5, dhe në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit III për Fitimin e Gradës Shkencore “Doktor” në Muzikologji, Neni 15, Pika 2, parashtrojmë si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2023-2024 gjykojmë se, përpos atyre egzistuese të pashpallura në vitin akademik 2022-2023, kuotat të shtohen me 7 kandidatë.
2. Njëherazi, përpos udhëheqëseve aktualë të miratuar, të shtohen gjithashtu edhe 2 (dy) udhëheqës të tjerë të cilët plotësojnë kriteret sipas legjislacionit në fuqi. Më konkretisht **Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi** dhe **Prof. Asoc. Dr. Kastriot Tusha**.

Prof. Asoc. Dorian Çene
Përgjegjës i Njesisë Bazë KMDP